

## Votuesit kërkojnë më pak premtime e më shumë punë

Derisa fushata zgjedhore ishte hapur zyrtarisht, një gomari i vogël i quajtur Polli shëtiste nëpër qendrën e Prishtinës duke kërkuar vëmendje të plotë nga kalimtarët e rastit, të cilët ndalonin për ta përkdhelur apo për tu çuditur me parullën që ai mbante.

Zana Limani dhe Driton Maliqi, IWPR

Gomari shëtiste me posterë të mëdhenjë të figurave kryesore politike me slogane të ndryshme që mbulojnë pothuajse secilën pano në qytet dhe muret e secilës ndërtese publike.

Po atë ditë, një grup i pavarur i të rinjve të quajtur 'Lëvizja', e morën shokun e tyre Pollin për një sheti nëpër qytet.

Njerëzit që kishin nxjerr gomarin për sheti nëpër qytet ishin përfaqësues të organizatës 'Lëvizja.com', një lëvizje e të rinjve që duan të nxisin ndryshime sociale. Ata e paraqitën gomarin si kandidat të pavarur në zgjedhje me një parullë të mbështjellë rreth tij në të cilën shkruante "Votoni për mua, pasi unë ju garantoj pavarësi."

Krenar Gashi, 21 vjeçar dhe një nga themeluesit e 'Lëvizjes' thotë se qëllimi i këtij aktiviteti ka qenë të tregojmë se njerëzit janë lodhur duke votuar për premtime boshe të politikanëve, të cilët mendojnë se mund të bëjnë fushatë duke pasur vetëm pavarësinë në agjendën e tyre.

"Njerëzit po qeshin me këtë shaka por në të vërtetë do të duhej të qanin sepse cilindo



Florim Beqiri, është tepër i zhgënjyer me atë që qeveria ka bërë gjatë 3 viteve të fundit. Foto: H. Sopa/OSBE

### NË KËTË NUMËR

Një mori sfidash për votuesit? fq. 4

Programi i rindërtimit në fazën përfundimtare fq. 9

Studentët për më shumë reforma fq. 10

Mediat testohen për të katërtën herë fq. 11

politikan që ta zgjedhim me gjasë vetëm do të përfitojë personalisht nga pozita në qeveri," tha Gashi.

Dëshpërimi i Krenarit në institucionet vendore ka arritur pikën sa që ai mendon se nuk ia vlen të dilet në votime fare.

Sidoqoftë, jo shumë njerëz mendojnë se bojkotimi i zgjedhjeve është zgjidhje për problemet e Kosovës.

Florim Beqiri, 32 vjeçar, shitës i librave, tha se do të votojë edhe pse është i zhgënjyer rëndë me atë që qeveria ka bërë gjatë 3 viteve të fundit.

"Shumë politikanë kanë dhënë premtime bazuar në pritjet e vogla të njerëzve duke ditur që njerëzit nuk janë mirë të edukuar; për shkak të sistemit të dobët të arsimit në Kosovë gjatë 15 viteve të fundit shumica e popullatës nuk është e vetëdijshme të

kërkojë të drejtat, liritë dhe shërbimet që duhet t'i gëzojnë nga shteti," thotë Beqiri.

Beqiri është i bindur se rrënjët e problemeve institucionale në shoqërinë kosovare qëndrojnë në strukturat partiake të korruptuara.

"Partitë janë shëndërruar në një lloj biznesi," thotë Beqiri. "Ato punojnë për përfitim të tyre dhe nuk e mbajnë asnjë premtim që japin."

Por Beqiri shpreson në partitë dhe lëvizjet e reja të cilat kanë dalur në skenë gjatë këtij viti.

Arsim Mexhuvani, poashtu shitës i librave, i cili qëndron pranë Beqirit, ndanë të njëjtin mendim për institucionet por shprehet se është posaqërisht i brengosur për kulturën dhe arsimin.



**Sven Lindholm,**  
zëdhënës i Misionit të OSBE-së në Kosovë

## Të dashur lexues

Përgjegjësia përkufizohet si diçka që kërkohet apo pritet për të arsyetuar veprimet dhe vendimet. Qeveria në të gjitha nivelet duhet të ketë përgjegjësi për atë që bën, përndryshe do të mund të bënte çfarë të dëshironte dhe të mos merrte parasysh dëshirat dhe nevojat e popullit.

Në shumë shoqëri, zgjedhjet shpesh janë një lloj testi për qeverinë në pushtet për të parë nëse votuesit mendojnë që ajo ka bërë punë të mirë ose jo. Zgjedhjet janë forma më e dukshme e përgjegjësise, por kjo është diçka në të cilën duhen të marrin pjesë të gjithë njerëzit gjatë gjithë kohës në mes të zgjedhjeve. Ata duhet të marrin pjesë në proceset vendimarrëse.

Në këtë kontekst, Kosova nuk ndryshon. Derisa ky edicion i 'Detaje'-ve po publikohet, ne jemi në mes të fushatës zgjedhore për Kuvendin e ardhshëm të Kosovës. Kuvendi dhe Qeveria kanë qenë në pushtet për tri vite. Këto zgjedhje mund të shihen si një test për punën që ata kanë bërë deri tani, dhe në këtë edicion ju mund të lexoni për disa çështje të cilat janë të një rëndësie të veçantë për masën e gjerë. Qeverisja ka qenë në duar të këtyre institucioneve, të cilat kanë marrë përgjegjësinë nga populli për të qeverisur.

Kur fushata filloi, OSBE-ja shpresonte se të gjitha subjektet politike do të garojnë për vota në mënyrë demokratike dhe të adresojnë çështje që janë të rëndësishme për popullin, siç janë: krijimi i vendeve të reja

të punës, arsimit, shëndetësia, si dhe shumë çështje të tjera të kësaj natyre dhe kjo për arsye se masa e gjerë duhet të presë përgjigje dhe zgjidhje e jo vetëm premtime boshe nga udhëheqësia e tyre politike. Kuvendi dhe Qeveria kanë përgjegjësi të madhe për përmirësimin e situatës në Kosovë.

Në përgjithësi, me disa përjashtime, kjo nuk ka ndodhur. Debatet dhe tubimet zgjedhore kanë ndjekur modelin e zakonshëm të zgjedhjeve të mëparshme të premtimeve boshe. Njerëzit meritojnë përgjigje dhe zgjidhje.

Zgjedhjet janë të rëndësishme. Këto zgjedhje janë të rëndësishme. Këto zgjedhje do të rezultojnë me një Kuvend dhe Qeveri të re, të cilat do të kenë përgjegjësi të mëdha për përmirësimin e situatës në Kosovë dhe për ta udhëhequr Kosovën në rrugën e parashtruar përmes standardeve. Votuesit janë përgjegjës për të ardhmen e tyre, dhe ju jeni ata të cilët duhet të kërkonin përgjegjësi nga partitë dhe politikanët. Udhëheqësit politik duhet të japin përgjigje dhe zgjidhje. Kjo do t'iu ndihmojë votuesve për të bërë një zhgjidhje të drejtë me 23 tetor.

Shpend Tetori



## DETAJE

Gazetë e publikuar nga OSBE-ja

OSCE HQ, 38000 Prishtinë / Prishtina  
Tel (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188  
E-mail: [press.omik@osce.org](mailto:press.omik@osce.org)  
Web site: [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)

Botuesi:

Sven Lindholm

Kryeredaktorë:

Chris Cycmanick

Redaktorë:

Hasan Sopa, Armend Tahirsylaj (Detaje)

Slavisa Mladenović (Detalji)

Faqosja:

Shpend Kada

Vizatimet:

Shpend Kada

Bashkëpunorët:

Arben Hajredinaj, Magdalena Hejzyk, Rexhep Krasniqi,

Fatime Lepaja, Zana Limani, Driton Maliqi,

Gëzim Rexha, Halide Sadiku, Mevlode Salihu,

Adriana Sejdiu, Vasilija Stanić, Bernard Vrbanić

**osce**

Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

## Zgjedhjet



Foto: "Lëvizja"

## vijon nga faqja 1

Ai thotë se institucionet vendore kanë dëshuar, në mes tjerash që të bëjnë përmirësime në fushat e kulturës dhe arsimit.

"Pse pra të votoj për ta," tha Mexhuvani. "Kanë pasur katër vite për tu dëshmuar dhe kanë dështuar tmerrësisht. Vetëm shikojeni ekonominë që po dështon dhe çështjen e pazgjidhur të statusit. Ata ia kanë lidhur këmbët vetit.

Por ndjenja e përgjithshme është shumë e qartë. Njerëzit ndihen të lënë anash nga partitë e tyre dhe mendojnë se partitë nuk i adresojnë shumicën e problemeve të tyre.

"Ata vetëm i kërkojnë votat tona," thotë Fetija, studente 20 vjeçare, "në vend që t'i fitojnë ato me punën e tyre."

Reduktimet e energjisë elektrike dhe mungesa e ujit, të cilat kanë kaluar gati në rutinë, në shumë rajone të Kosovës paraqesin një problem të përditshëm për kosovarët.

"Qeveria është dashur të bëjë diçka për këto reduktime," tha një pronar dyqani. "Unë do t'ia jap votën dikujt që më ofron zgjidhje për këtë problem."

Sipas një raporti për Kosovën të publikuar këtë shtator nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), këto zhgënjime po rezultojnë në zvogëlim të numrit të votuesve.

Derisa 79 përqind e elektoratit kanë votuar në zgjedhjet e para në vitin 2000, përqindja e votuesve ka rënë vazhdimisht, kështu në vitin 2001 pjesëmarrja e votuesve ka qenë 64%, dhe në zgjedhjet e fundit të vitit 2002 vetëm 54%.

"Dalja në votime e elektoratit është zvogëluar vazhdimisht nga zgjedhjet e para, pjesërisht ndoshta se njerëzit nuk shohin ndonjë përfitim në pjesëmarrje," qartëson raporti i UNDP-së. "Për ta përmirësuar këtë trend, populli duhet bindur se mund të ketë ndikim në procesin politik."

Partia kryesore, Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, e cila ka 48 nga 120 vende në parlament, ka filluar fushatën e saj zgjedhor me moton 'Liri, Pavarësi, Demokraci.'

Melihate Tërnkolli, kryesuese e shtabit zgjedhor të LDK-së, nuk mendon se zhgënjimi i popullit do të kthehet në humbje të votave për LDK-në.

"Është arritur përparim në disa fusha dhe ne kemi bërë gjithçka që ka qenë në duart tona për të përmirësuar situatën. Njerëzit e dinë këtë - përkrahja jonë është rritur," tha Tërnkolli.

Edhe pse arritja e pavarësisë është ende qëllimi kryesor dhe prioriteti numër një i LDK-së, Tërnkolli tha se këtë vit LDK-ja ka hartuar plane për zbutjen e problemeve si p.sh. atë të papunësisë.

Gjëja e parë që ata do të bëjnë nëse i fitojnë zgjedhjet, është miratimi i ligjeve për pronën si dhe ligje tjera për të krijuar bazë ligjore për investime të huaja.

"Kjo do ta përmirësonte ekonominë dhe do të krijonte vende të reja të punës," tha Tërnkolli.

Partia Demokratike e Kosovës, PDK, partia e dytë më e madhe në Kosovë, e cila ka 26 vende më parlament, pranon se Kuvendi nuk ka miratuar ligje aq sa është pritur nga ai, dhe kjo si rezultat i funksionimit jo të mirë

brenda kuvendit si dhe hezitimit të qeverisë për të sponsoruar ligje në parlament.

PDK-ja, moto e së cilës është 'Punë, Shtet, Dinjitet', premtonte se nëse i fitojnë zgjedhjet do të zvogëlojnë papunësinë nga 70% në 40% për katër vite.

Xhavit Haliti, kryesues i shtabit zgjedhor të PDK-së thotë, "PDK-ja do të angazhohet në krijimin e kushteve për një jetë më të mirë dhe krijim të vendeve të reja të punës."

Por, sipas Halitit, arsimit dhe kulturës nuk do të mbesin prapa në asnjë mënyrë. Nëse fiton PDK-ja, ministria e kulturës do të investojë në ndërtim dhe zhvillim të teatrit, operës dhe baletit, derisa ministria e arsimit do të ofrojë më shumë bursa për studentë të daluar.

Një nga subjektet politike të reja, që merr pjesë në zgjedhje për herë të parë, iniciativa qytetare 'ORA', kritikon institucionet e përkohëshme se e kanë sjellur Kosovën në këtë gjendje depresioni dhe stagnimi.

Sipas tyre, partitë në pushtet kanë dëshmuar se nuk kanë mundur t'iu ofrojnë qytetarëve jetë të mirë dhe perspektivë me politikën që kanë ndjekur gjatë pesë viteve të fundit.

Labino Salihu, përfaqësues nga 'ORA' thotë se ata synojnë ta nxjerrin Kosovën nga ky rreth i mbyllur i degradimit dhe stagnimit dhe ta udhëheqin atë në botën moderne.

"Shumë njerëz të angazhuar në 'ORA' janë aktivist të shoqërisë civile dhe janë në kontakt me problemet dhe hallet e përditshme të qytetarëve," tha Salihu. "Shumë parti i neglizhojnë nevojat e qytetarëve dhe angazhohen për ta vetëm gjatë kohës së zgjedhjeve ose kur iu duhet diçka nga ta."

Por, partitë e reja ballafaqohen me sfida të mëdha për t'i bindur votuesit të cilët janë të prirur t'i japin votën e tyre partive me më shumë traditë. Disa frikësohen se mungesa e përvojës së partive të reja do ta kthejë Kosovën në zero, duke i lënë partitë e reja të shfrytëzojnë kohën për të fituar përvojë të mjaftueshme për të rindërtuar institucionet nga fillimi.

"Ne nuk jemi të sigurtë t'i japim votën partive dhe njerëzve që i njohim aq mirë, e lere më njerëzve që sapo kanë hyrë në politikë," thotë Fetija Krasniqi.

Të gjendur në mes të rezultateve të arritura gjatë tri viteve të fundit dhe premtimeve të shumta nga partitë politike në vitin 2004, kosovarët duhet t'i qartësojnë prioritetet e tyre dhe të vendosin çfarë dëshirojnë të ndryshojnë me 23 tetor.

Zana Limani dhe Driton Maliqi janë kontribues nga IWPR-ja (Instituti për Raportim në Luftë dhe Paqë)

# Një mori sfidash për votuesit: Institucionet e përkohshme në qendër të vëmendjes

Më 23 tetor, më shumë se 1.3 milion votues të regjistruar do të kenë të drejtën të hedhin votën e tyre dhe të ndikojnë në strukturën e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ). Populli i Kosovës do të ketë mundësinë të zgjedh në mes të 32 subjekteve të çertifikuara politike, përfshirë këtu partitë politike, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur.

**Bernard Vrban, OSBE**

Më 23 tetor, më shumë se 1.3 milion votues të regjistruar do të kenë të drejtën të hedhin votën e tyre dhe të ndikojnë në strukturën e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ). Populli i Kosovës do të ketë mundësinë të zgjedhë njërin nga 32 subjektet e çertifikuara politike, ku përfshihen partitë politike, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur.

Elektorati do të votojë për Kuvendin e Kosovës me 120 vende, që është organi legjislativ i IPVQ-ve. Por, kjo votë do të ndikojë edhe në strukturën e qeverisë së re, si organ ekzekutiv i IPVQ-ve. Prandaj, është me rëndësi të dihet se çka bëjnë këto organe, çfarë kompetencash kanë ato, çka kanë bërë gjatë mandatit të tyre të parë si dhe me çka do të ballafaqohen në mandatin e tyre të dytë.

Votuesit e informuar kanë njohuri jo vetëm për çështjet e zgjedhjeve, por gjithashtu edhe ku të drejtohen që të sigurohen se zërat e tyre dëgjohen dhe ku të kërkojnë përgjigje për problemet që ndikojnë në shoqëri. Si në çdo shoqëri, votues i mirë është votuesi i informuar.

Korniza Kushtetuese i tregon qartazi përgjegjësitë e IPVQ-ve. IPVQ-të janë përgjegjëse që të sigurojnë se legjislacioni dhe praktikat janë në pajtim me standardet dhe normat relevante evropiane dhe ndërkombëtare. Natyrisht, ka edhe kompetenca të rezervuara (të cilat janë në Kapitullin e 8 të Kornizës Kushtetuese) të cilat nuk janë nën IPVQ-të.

## Roli legjislativ i Kuvendit

Kapitulli 9 i Kornizës Kushtetuese e përcakton rolin e Kuvendit të Kosovës; organi më

i lartë legjislativ. Anëtarët e kuvendit janë përgjegjës për nxjerrjen e ligjeve dhe rezolutave nga fushat nën kompetencat e IPVQ-ve. Sferat e jetës në të cilat kuvendi mund të nxjerrë ligje, por të cilat nuk janë të kufizuara vetëm në to janë: puna dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, arsimimi, shkenca dhe teknologjia, bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural si dhe transporti dhe telekomunikacioni.

Kuvendi i parë i Kosovës, në tri vitet e tij të para, miratoi më shumë se 90 ligje (bazuar në informatat e kuvendit), edhe pse të gjitha ato nuk janë aprovuar nga përfaqësuesi special i kombeve të bashkuara. Ligji i parë që u miratua ishte Ligji për mënyrën e përcaktimit të shkallës për pension themelor (Ligji 2002/1). Ligjet e tjera janë nga fusha të ndryshme, siç janë ligji për tregëti me jashtë (2002/6), mbi rrugë (2003/11), shërbime postare (2003/18), sport (2003/24), energjetikë (2004/11) dhe ligji për përpunimin e metaleve të çmuara (2004/28)

Fatëkeqësisht, Kuvendi në disa raste i ka kaluar kompetencat e tij gjatë verës së vitit 2004, kuvendi u përpoq që të bëjë ndryshime në 'Kornizën Kushtetuese'. Tani së voni, një draftligj për bashkpunim me Tribunalin e Hagës u konsiderua se i ka kaluar kompetencat e IPVQ-ve. Incidentet si ky janë kritikuar jo vetëm nga UNMIK-u por edhe nga bashkësia ndërkombëtare.

## Legjislativi mbi ekzekutivin

Kuvendi gjithashtu është përgjegjës për emërimin e qeverisë, e cila përbëhet nga zyrja e kryeministrit dhe një numër ministrish, të cilat janë përgjegjëse drejtpërdrejtë për fushat nën kompetencat e tyre.

Prioritet e krijuara për këtë qeveri në pjesën e parë të vitit 2002 ishin: 1) konsolidimi i strukturave demokratike të Kosovës; 2) ngritja e transparencës dhe efikasitetit në administratë; 3) përmirësimi i standardeve arsimore; 4) përmirësimi i kualiteti të shëndetësisë; 5) promovimi i zhvillimit ekonomik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar; 6) shtimi i punësimit; 7) themelimi i sigurimit pensional dhe asistencës sociale për grupet e rrezikuara; dhe 8) integrimi i të gjitha komu-

niteteve etnike në shoqërinë Kosovare.

Në pajtim me normat e 'Kornizës Kushtetuese' dhe rregulloret procedurale, qeveria ka të drejtë të propozoj ligje, gjë të cilën mund ta bëjnë edhe akterët tjerë. Përveç votimit të ligjeve, kuvendi i ofron këshilla qeverisë kur ajo është duke përgatitur ligje (të cilat më vonë dorëzohen në kuvend).

Megjithatë, kjo është vetëm një nga shumë kompetencat dhe përgjegjësitë të cilat i ka qeveria. Si degë e ekzekutivit, qeveria është përgjegjëse për udhëheqjen e 'vendit'. Ajo është institucioni i vetëm që ka implementuar në mënyrë aktive ligjet e nxjerrura nga Kuvendi dhe të miratuara nga PSSP-ja.

Natyrisht, shkalla e suksesit të kësaj qeverie në përbushjen e këtyre prioritetëve do të matet më së miri nga përgjigjja e elektoratit më 23 tetor. Votuesit do të japin mendimin e tyre në mënyrën më të mirë ditën kur ata hedhin votën e tyre.

## Sfidat me të cilat ballafaqohen IPVQ-të

IPVQ-të duhet që edhe më tutje të mirren me çështjet socio-ekonomike dhe të mundohet që të përmirësoj jetën e banorëve të Kosovës. IPVQ-të e ardhshme do të jenë përgjegjëse për implementimin e plotë të 'Standardeve për Kosovën'. Ato ose do ta çojnë Kosovën përpara dhe më afër Evropës, duke e pranuar seriozisht punën të cilën duhet ta bëjnë, ose do ta lënë atë aty ku është duke diskutuar dhe duke u munduar që ta fajsojnë bashkësinë ndërkombëtare para publikut, faj të cilin ajo nuk e ka. Suksesi apo dështimi i tyre do ta përcaktojë në masë të madhe vendin e Kosovës në rajon dhe Evropë.

Në këto zgjedhje, elektorati i Kosovës do të vendosë se cili është subjekti më i mirë politik që do të jetë i aftë të përbushë këto sfida dhe do ta përmirësoj kualitetin e jetës së të gjithëve. Bashkësia ndërkombëtare mundet të mbajë disa kompetenca të rezervuara të cilat janë të barabarta me sovranitetin, por pjesa dërmuese e tyre, që lejojnë vetëqeverisjen e që është ajo të cilën mëton ta adresojë Rezoluta 1244, tashmë janë në duart e zyrtarëve vendor të zgjedhur e të emëruar. Elektorati duhet t'ia bëjë me dije udhëheqësisë politike se kujt ata i besojnë më së shumti se do të bëjë progresin e nevojshëm.

Veb-faqet e Kuvendit të Kosovës dhe qeverisë së Kosovës janë [www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org) dhe [www.pm-ksgov.net](http://www.pm-ksgov.net). Informatat që janë në këto dy veb-faqe janë përdorur për shkruarjen e këtij artikulli.



"Në këto zgjedhje, elektorati i Kosovës do të vendosë se cili është subjekti më i mirë politik që do të jetë i aftë të përbushë këto sfida dhe do t'a përmirësoj kualitetin e jetës së të gjithëve" Foto: Kotek/OSBE

# Energji elektrike po, por me çfarë çmimi?

Kur dikush në Kosovë bën pyetjen “cili është problemi i përditshëm më i padurueshëm këtu?” pothuajse menjëherë e dëgjon përgjigjen, “ndërprerjet e rrymës elektrike


Magda Hejzyk, OSBE

Furnizimi normal me rrymë elektrike ka qenë një problem për gjithë popullatën e Kosovës. Ç’është më e keqja, përderisa nuk janë në gjendje të sigurojnë shërbim të rregullt, dy termocentralet kryesore të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në Obiliq shkaktajnë një ndotje të madhe në ajër e cila përmban një kërcnim serioz për shëndetin e kosovarëve. Sidoqoftë, pas disa viteve të mospërfilljes së këtij problemi, më në fund çështja e termocentraleve ndotëse u ndriqua, edhe në shtypin vendor, por edhe tek banorët e prekur drejtpërdrejt nga ky problem. Gjithashtu, duket se autoritetet po i ndërmarrin hapat e parë drejt zgjidhjes së problemit me termocentralet e KEK-ut.

KEK-u, pavarësisht shërbimit të tij të kohpaskohshëm, ende është furnizuesi më i madh i energjisë në tregun e Kosovës. Dy termocentralet, Kosova A dhe B, të vendosura në një fshat afër Obiliqit, shumë lehtë bien në sy. Termocentralet janë të mëdha, të hirëta, me strukturë betoni, me oxhaqe prej 70 metrash të cilat lëshojnë tonelata hiri dhe shumë shpejt mbulojnë hapsirën përreth me një mbulesë ndotëse.

Kosova B, e cila përbëhet nga dy njësi, është më e re dhe ka filtrues të cilët punojnë me kapacitet të largimit prej 98%. Kosova A, e përbërë prej pesë njësive, punon me një shkallë largimi në mes 50-80%. Një nga blloqet e saj prej 200MW lëshon rreth 25 tonelata pluhur brenda një ore, 74 herë më tepër se stanadardet evropiane për ndotje. Mungesa e përkujdesjes së duhur ndaj dy termocentraleve është një brengë e madhe. Filtruesit e dëmtuar apo të padobishëm, shumë shpesh të ndalur nga punëtorët me qëllim të ngritjes së kapacitetit të prodhimit, shkaktajnë edhe më shumë ndotje dhe rrezik për shëndetin. Prandaj, kur retë e tymit nënkuptojnë rrymë elektrike në shtëpitë e shumicës, ato janë sinonim për t’i helmuar ata të cilët jetojnë në afërsi.

Sektori i energjetikës, posaçërisht në regjionin e gjërë të Prishtinës, është ndotësi më i madh në Kosovë, dhe rreth 97% e tërë energjisë së prodhuar në Kosovë sigurohet nëpërmes djegjes së thëngjillit në termocentralet. Termocentralet elektrike të KEK-ut me djegje thëngjilli lirojnë sulfur, azot dhe oksid të karbonit, si dhe pluhur në një ambient tashmë shumë të ndotur nga automjetet dhe gjeneratorët. Të fundit janë një burim alternativ i energjisë gjatë ndërprerjeve të rrymës si dhe emetuesit kryesorë të ‘zhurmës ndotëse’. Për më tepër, përveç zhregullimit të furnizimit me ujë natyral, termocentralet krijojnë lartësi të ndërtuara me më tepër se 40 milionë tonelata hi dhe përfshijnë afërsisht 150 hektarë të tokës bujqësore në shqyrtim.



“Fshatarët e fshatrave për rreth KEK-ut pohojnë se hiri ua ka shkartruar tokën pjellore. Foto: Sopa/OSBE

Përzjerja e ajrit të ndotur, dheut dhe ujit në hapsirën e Obiliqit, rezultojnë në probleme të shumta shëndetsore tek banorët. Fshatrat në afërsi tregojnë incidentet më të mëdha të sëmundjeve të mushkërive, infeksioneve të respiratorëve të lartë dhe të ulët, diarësë akute, parazitëve të zorrëve dhe zgjebës. I bartur nga era, hiri mpikset në mushkëri dhe nuk hiqet kurrë. Sidoqoftë, të jemi të sinqertë, gjendja shëndetësore nuk është shkaktuar vetëm nga termocentralet, por edhe nga uji për pije, nga mungesa e kushteve sanitare dhe higjienës së dobët personale tek shumë njerëzve. Megjithatë, shumë nga kjo mund t’i lihet termocentraleve.

Njerëzit nga fshatrat përreth ankohen se hiri e ka shkartruar tokën e tyre që dikur ishte pjellore. Shumë banorë të Krushcit, një fshat i vendosur në mes të termocentraleve dhe grumbujve të hirit, vuajnë nga sëmundjet e frymëmarrjes, e madje edhe prej kancerit. Hiri, i cili e bën jetën në hapsirën e Obiliq shumë të vështirë, gjithashtu arrin edhe tek qytetet tjera të afërta. Për shembull, një erë pak më e fortë se normale mund të bart grimca deri në 10 kilometra, pra deri në Prishtinë.

Duke iu përgjigjur çështjes së ndotjes, z. Zeqir Veselaj, këshilltar në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH), tha se e vetmja mënyrë në të cilën mund të ketë ndikim qeveria në aktivitetet e KEK-ut është që të nxjerrë ligje të cilat në të ardhmen do ta shtyejnë kompaninë të zvogëlojë ndotjen. Fatkeqësisht, sipas tij, zbatimi i ligjit do të marrë kohë me vite. Z. Veselaj theksoi se Ministria, e themeluar në qershor 2002, mundet vetëm të shqyrtojë prioritetin urgjent për nxerrjen e një kornize të fuqishme ligjore për administratën hapsinore. Për të arritur

këtë, MAPH-ja së fundi ka hartuar një raport të titulluar ‘Strategjia për ambientin dhe zhvillimin e qendrueshëm’. Në kohën kur ky artikull po shkruhej, draftligji ishte duke kaluar nëpër procedurat parlamentare.

Sipas dokumentit, prioritetet e MAPH-së lidhur me Obiliqin në mes tjerash janë: “Ndërrimi i paisjeve të vjetra në sektorin e energjisë, largimi dhe posedimi i fushave të caktuara të hirit ekzistues nga termocentralet, si dhe rehabilitimi dhe rikultivimi i kraterëve të krijuara gjatë kohës kur përdorimi i lignitit bëhej përmes minierave të hapura të qymyrit”.

Lista e prioriteteve të MAPH-së është shumë më e gjatë. Sidoqoftë, ka shumë pyetje: A do të jenë ata në gjendje të arrijnë qëllimet e tyre? Krijimi i një kornize të duhur ligjore është një hap në drejtim të duhur. Mirëpo, pastaj shumë shpejt duhet të ndërmiren masa të tjera të cilat do të sjellin më tepër rezultate, dhe jo vetëm nga autoritetet qeveritare por gjithashtu edhe nga vetë qytetarët.

Së pari, një fillim i mirë do të ishte zbatimi i ligjit të tanishëm. Tani, në hapsirën e ndotjes së ambientit ligji është joadekuat. E dyta, nëse do të vendosen filtrues të rinj në termocentralet dhe të shfrytëzohen në mënyrë të duhur, financimi për blerjen e tyre do të lidhej me një qëndrim të ri mesin e kosovarëve, një prej të cilëve është që qytetarët t’i paguajnë faturat e tyre elektrike.

Me kufizimet financiare, shteti nuk mund t’iu sigurojë qytetarëve furnizim më të pastër dhe më të shëndetshëm të energjisë pa një burim të caktuar të të ardhurave drejtëpërdrejt të lidhura me shfrytëzimin e asaj energjie. Rruga deri tek energjia elektrike e rregullt dhe e pastër është, ashtu si edhe shumë çështje tjera, rrugë dykahëse.

## Si të kuptohet sistemi elektoral

### Të dhëna shkurtë

*Sistemi elektoral i cili është nxjerrur nga KornizaK kushtetuese është shumë i qartë*

#### Përfaqësimi proporcional

- Kjo do të thotë se ulëset në Kuvend janë të ndara sipas numrit të votave të fituara nga secili entitet politik.
- Kuvendi ka 120 ulëse.
- Të gjitha partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, që do të konkurojnë në zgjedhje, do të garojnë vetëm për 100 prej këtyre ulëseve.
- Pasi që sistemi elektoral është një përfaqësim proporcional, nëse një entitet fiton, për shembull 60% të votave në mbarë Kosovën, kjo parti do të fitojë përafërsisht 60 ulëse në Kuvend.
- 20 ulëset e tjera të Kuvend janë të njohura si ulëse të rezervuara.
- Këto ulëse janë të rezervuara për komunitetet më të vogla në mënyrë që atyre t'iu garantohet zëri i tyre në Kuvend.
- Ulëset e rezervuara do të ndahen në proporcion me numrin e votave të fituara në këto zgjedhje nga subjektet politike të komuniteteve më të vogla.

### " Kosova, zonë e vetme zgjedhore "

Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, Kosova do të konsiderohet si zonë e vetme zgjedhore.

Kjo poashtu është një qasje mjaft e drejtë.

Kjo nënkupton se kudo që një person i caktuar voton, vota e tij do t'i numrohet subjektit politik për të cilin personi voton.

Nga kjo do të përfitojnë të gjitha partitë duke përfshirë edhe ato të voglat sepse iu ofrohen mundësi më të mëdha për fitimin e ulëseve ngase nuk do të varen nga përkrahja në regjione të veçanta të Kosovës.

### Si ta dini se për kë po votoni?


Njerëzit do të votojnë për subjektin që kanë zgjedhur.

Janë më se 1,300 kandidatë nga të gjitha entitetet që garojnë në zgjedhjet e këtij viti.

Pra, subjektet politike kanë përpiluar listat e kandidatëve dhe kanë bërë radhitjen e tyre me anë të së cilës ata do të zgjidhen. Për shembull, një parti mund të fusë 110 kandidatë në garë por të fitojë vetëm 40 ulëse. Kjo do të thotë se 40 kandidatët e parë në listë do të fitojnë ulëse në Kuvend.

Pa dyshim, ju do ta dini se për kë do të votoni. Listat e kandidatëve si dhe informatat e nevojshme për të gjitha vendvotimet do të publikohet para ditës së zgjedhjeve.

Zgjedhjet




ÇKA DO TË THOTË PËRFAQËSIMI PROPORCIONAL?

Partia A	=	33.0% të votave
Partia B	=	12.0% të votave
Partia C	=	8.0% të votave
Partia D	=	3.0% të votave
Partia E	=	6.0% të votave
Partia F	=	4.0% të votave
Partia G	=	17.0% të votave
Partia H	=	8.0% të votave
Partia I	=	9.0% të votave

100.0% të votave

Nga kjo rezulton numri i mëposhtëm i ulëseve:



**Shpjegim:**

Nëse partia apo kandidati A fiton 33% të numrit të përgjithshëm të votave atëherë do të marrë 33% të 100 ulëseve çka do të thotë se do të fitojë 33 ulëse në Asamble.

Nëse partia apo kandidati D fiton 3% të numrit të përgjithshëm të votave atëherë do të marrë 3% të 100 ulëseve çka do të thotë se do të fitojë 3 ulëse në Asamble.

# Qytetarët porosisin liderët Kosovar

Fushata elektorale tani më ka filluar, por cilat janë brengat e votuesve dhe çfarë zgjidhjesh do t'iu ofrohen atyre kësaj radhe?

Hasan Sopa, OSBE

Sa herë që ofrohen zgjedhjet e reja, votuesi Kosovar gjendet para shumë dilemave. Është koha kur partitë politike fillojnë me premtime, të cilat edhe vetë ata dyshojnë se do t'i realizojnë. Disa bile mendojnë se në Kosovë nuk ekzistojnë rrethanat për t'i realizuar ato. Ndërsa, votuesve nuk u mbetet gjë tjetër pos t'i 'besojnë' njerit prej subjekteve politike, për të vetmin fakt se duhet të dalin në zgjedhje.

Me që jemi në prag të zgjedhjeve, 'Detaje-t' biseduan me disa qytetarë rasti për çështjet që ata i preokupojnë më së tepërmi. Është me rëndësi vitale për të gjithë në Kosovë, që këto zgjedhje të organizohen dhe mbahen në mënyrën më të mirë të mundshme, meqë ky mund të konsiderohet hapi i parë në ndërtim të demokracisë së mirëfilltë.

## Votuesit dhe politikanët

Një pikëpamje që doli nga shumë të anketuar ishte se partive politike në Kosovë dhe në përgjithësi politikajve kosovarë, ende u mungon përvoja e duhur në ushtrimin e pushtetit. Kjo, edhe përkundër përvojës disa vjeqare dhe ndihmës së bashkësisë ndërkombëtare në ngritjen e kuadrove në aspektin profesional.

Sipas Miradije Asllanajt e punësuar në institucionet vetëqeverisëse, programet e partive politike nuk duhet të përmbajnë vetëm formulime boshe si; 'kjo është ajo që ne dëshirojmë...' Pra, "ata duhet të thonë qartë dhe saktë se si mendojnë t'iu qasën çështjeve të mjedisit, përkujdesjes shëndetësore, sistemit arsimor e kështu me radhë." Ata, gjithashtu duhet të punojnë më tepër, siç ajo e quan, në 'ndarjen e përgjegjësisë' në mes tyre dhe votuesve.

## Problemet e përditëshme

Nuk ka dyshim se votuesit kanë forcën më të madhe për ndryshimin e skenës ekzistuese politike. Por, athua janë të vetëdijshëm votuesit tanë se ata vërtetë mund të bëjnë ndryshime?

"Demokracia fillon nga baza dhe votuesit duhet të mësohen të kërkojnë më tepër nga liderët e tyre politikë dhe t'i bëjnë ata më të përgjegjshëm," thotë znj. Asllanaj. "Votuesit duhet të kuptojnë se partitë politike i përfaqësojnë dhe u shërbejnë atyre dhe jo e kundërta e kësaj". "Nga ana tjetër", vazhdon znj. Asllanaj, "partitë politike duhet të kuptojnë se duhet punuar shumë më tepër në premtimet e tyre zgjedhore, ose ndryshe rrezikojnë t'i humbin votat radhën tjetër".

Alma Lama gazetare në RTK, mendon se Kuvendi i ardhshëm duhet ta racionalizojë kohën krejt ndryshe nga sa ka bërë Kuvendi aktual, qoftë edhe në kuptimin e intensitetit të punës. "Sigurisht se nxerrja e ligjeve është



Pamja e një rruge të Prishtinës gjatë fushatës zgjedhore. Foto: Sopa/OSBE

me rëndësi", shton ajo, "por në të ardhmën Kuvendi duhet që më tepër të merret me problemet themelore që ka sot shoqëria".

Nuk është gjithmonë e rëndësishme që Kuvendi të mirret me statusin final sepse kjo gjë edhe nuk varet shumë nga Kosova sipas znj. Lama. "Sugurisht që duhet të ketë ide të qarta edhe në këtë drejtim, por më e rëndësishme është të merret me probleme konkrete: si krijimi i politikave ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës". Sipas saj, edhe vet qeveria ka pranuar se ka mungesë ideshë në hartimin e këtyre politikave, pra të shfrytëzimit të resurseve që ka Kosova.

## Korrupcioni në institucione

Një tjetër çështje brengosëse sipas znj. Lama është korrupcioni. "Mjafton të përmendim institucionet e shëndetësisë ku shërbimi është jashtëzakonisht i dobët dhe korrupcioni është në majat më të larta".

"Shëndetësia në Kosovë është në gjendje të mjerueshme", thotë Destan Berisha ulur në një kafene interneti. "Përderisa në vendet tjera, është rregull që nga çasti kur pacienti shtrohet në spital, në njëfarë mënyre përfundon detyra e familjarit. Kurse tek ne është e kundërta, tek atëherë do të fillojnë mundimet dhe përpjekjet duke vrapuar pas barnave, mjekëve, laboratoreve dhe pas intervenimeve. Mos u sëmuresh", psherëtinë Berisha.

## Familjarizmi dhe politika në sistemin shkollor

Situata në sistemin arsimor, shpesh doli nga bashkëbiseduesit tanë si mjaft shqetësuese. Njerëzit shohin probleme të jashtëzakonshme në univerzitet, ku duket se ka mungesë

kuadros, mungesë reformash dhe familjarizëm, gjë që do të thotë se kjo shoqëri nuk premtion shumë për zhvillim në të ardhmen.

Gëzim Krasniqi, nga iniciativa studentore 'Tjetër qysh', pak a shumë ndanë të njëjtin mendim. Ai thotë se familjarizmi është shqetësues në çdo degë të univerzitetit dhe se politika ka ndikim të madh.

"Unë kam patur fatin t'i lexoj statutet e disa partive politike ku ata premtojnë beneficionet që studentët do t'i kenë poqëse ata vijnë në pushtet. Premtojnë përmirësimin e kushteve të studentëve, ndarjen e bursave e kështu me radhë". Por sipas z. Krasniqi kjo nuk ndodhë: "Nëse një student dëshiron ta fitojë bursën, atëherë ai apo ajo, duhet të anojë politikisht, përndryshe nuk ka gjasa ta fitojë atë."

## Ndarja e përgjegjësisë

Transferimi i kompetencave ishte njëra prej temave të përmendura shpesh. "Duhet të bëhet definimi qartë i kompetencave", thotë z. Berisha "në mënyrë që të dihet saktë se kush për çka ka përgjegjësi. Qytetarët nuk besojnë se institucionet vetëqeverisëse kanë diçka në 'zotrim'. Më tepër mbisundon mendimi, si tek politikanët ashtu edhe të votuesit, se bashkësia ndërkombëtare ende kontrollon aspektet kryesore të administratës së përkohshme".

Z. Berisha thekson se definimi i kompetencave dhe përgjegjësisë është pjesë vitale e këtij procesi. Kosova ka nevojë për udhëheqës të përgjegjshëm më tepër se për çdo gjë tjetër dhe që kjo të ndodhë, është i nevojshëm aplikimi i mekanizmave për përgjegjësi. "Kjo është ajo që qytetarët e Kosovës duan, por kjo është ajo që duan edhe të gjithë ata që janë të përfshirë në ndërtimin e një shoqërie përgjegjëse", përfundon z. Berisha.



# Programi i rindërtimit hyn në fazën përfundimtare

Vasilija Stanić, OSBE

Nëse merret parasysh numri i ndërtesave të shkatërruara, atëherë Fushë Kosova do të ishte në mesin a atyre komunave që më së shumti janë goditur nga trazirat e marsit që e tronditën Kosovën në mesin e muajit mars të këtij viti.

Dy nga godinat më të rëndësishme të bashkësisë, Shkolla "Shën Sava" dhe Shtëpia e Shëndetit në Bresje, ishin në mesin e 139 ndërtesave private dhe publike të dëmtuara. Tash, gjashtë muaj më vonë, Shkolla e rindërtuar "Shën Sava" është rihapur. Puna në Shtëpinë e Shëndetit në Bresje së shpejti do të përfundojë.

"Unë jam këndshëm i befasuar me kohën e shkurtër që u nevojiti për ta kthyer në jetë shkollën, premtimet u mbajtën", thotë drejtori i njerës nga shkollat fillore, z. Radoslav Maroviq.

Kur përfaqësuesi i lartë i Bashkësisë Evropiane Javier Solana e vizitoi shkollën menjëherë pas trazirave, Radoslavi pyeti, "çka duhet t'iu them mësuesve dhe nxënësve të mi"? Drejtori i shkollës vazhdon: "Solana u përgjigj "shkolla do të jetë gati në shtator, kur të fillojë viti i ri shkollor". Kjo ndodhi dhe mua më vjen shumë mirë".

Pas konfliktit të vitit 1999, Shkolla 'Shën Sava' pranoi shumë nxënës të shpërngulur nga shkollat e tyre në Prishtinë dhe Fushë

Kosovë, duke i përfshirë kryesisht nxënësit nga bashkësia serbe dhe rome, që i ndiqnin mësimet në gjuhën serbe.

Perafërsisht, 300 nga këta nxënës u desh të vijonin mësimet në fshatin fqinj Uglarë, ku mësimet organizoheshin në katër ndërtime, për shkak të mungesës së hapësirës. Tash, të kthyer në Shkollën 'Shën Sava', që të dy palët, mësimdhënësit dhe nxënësit janë të kënaqur me kushtet në shkollën e tyre të rindërtuar.

Sidoqoftë, drejtorët e shkollës theksuan se renovimi i shkollës nuk duhet të përfundojë me kaq, sepse ka mbetur ende shumë për t'u kompletuar. Kjo përfshin ripajisjen e kabinetëve të kimisë, fizikës dhe biologjisë, si dhe zëvendësimin e shumë librave, nga 7,500 libra të rëndësishëm që kishin humbur. Edhe gjimnazi, edhe pse i renovuar, nuk është i pajisur me instrumente që ishin në sallë.

Gjithashtu është e rëndësishme që rindërtimi i shkollave të mos shikohet ndaras nga rindërtimi i godinave tjera të shkatërruara në mars. Rindërtimi i shtëpive dhe krijimi i kushteve për kthimin e personave të zhvendosur, që kryesisht janë të vendosur në baraka në Uglarë, do t'iu mundësonte fëmijëve që janë duke e vijuar mësimin diku tjetër të kthehen në Shkollën 'Shën Sava'.

"Unë kisha shtëpinë në Fushë Kosovë dhe të dy fëmijët e mi shkollin në Shkollën 'Shën Sava', thotë Jovica Rajković. "Pas 17 marsit unë dhe familja ime u vendosëm në baraka. Por, kur shkolla u rihap, vendosa t'a sjellë familjen time në fshatin fqinj Skulanovë, në mënyrë që ata të mund të shkollin në shkollë. Arsyja kryesore është se shtëpia e ime nuk është rindërtuar dhe është shumë e vështirë për tërë familjen time të jetojmë në atë barakë të vogël, posaçërisht kur dihet se ka restriksione të shpeshta të rrymës, pa ujë dhe kushte të varfëra higjienike...Nëse situata përmirësohet dhe krijohen kushtet për kthimin tonë, siguria, në rradhë të parë, ne do të dëshironim të ktheheshim në shtëpinë tonë në mënyrë që fëmijët tonë të mund të kthehen në shkollë".

Në Fushë Kosovë, prej 139 ndërtesave në listën për rindërtim, 34 shtëpi dhe Shkolla 'Shën Sava' janë përfunduar, derisa punët vazhdojnë në rindërtimin e 95 shtëpive tjera dhe shtëpisë së shëndetit.

Behxhet Brajshori, kryetar i 'Komisionit Qëndror Ndër-Ministror' për rindërtimin e objekteve të shkatërruara në mars, tha për Detajet se programi është duke hyrë në fazën finale.

"Qeveria e Kosovës ka ndarë 460, 000 euro për Shkollën 'Shën Sava'. Sidoqoftë, prioriteti i parë është rindërtimi i shtëpive," tha Brajshori. Ai shtoi se disa OJQ janë lutur që të ndihmojnë në përgatitjet teknike si organizimin e tenderëve, monitorimin e progresit dhe raportimin për komisionin.

"Deri tash, puna ka shkuar sipas planit dhe pritet që të gjitha shtëpitë e dëmtuara në Fushë Kosovë të përfundojnë deri në fund të tetorit," shtoi Brajshori. "Sa i përket Shtëpisë së Shëndetit, është e mundur që kompletimi i saj të vonohet pak, por besoj se edhe ajo do të përfundojë në tetor.

Nxënësit e Shkollës së Mesme të Mjekësisë shprehonin se pasi të përfundojë rindërtimi i Shtëpisë së Shëndetit, ata do të jenë në gjendje të vijojnë orët praktike në këtë institucion si më parë.



Shkolla fillore e Shën Savës në Fushë Kosovë me një pamje të re; fëmijët i gëzohen renovimit të shkollës së tyre. Foto: Sopa/OSBE

# Studentët kërkojnë më shumë reforma

Rexhep Krasniqi e Halide Sadiku, OSBE

Korridorët e Universitetit të Prishtinës janë përplot me studentë. Këta të rinjë janë plot jetë, gëzim, entuziazëm, energji dhe të etur për një të ardhme më të ndritshme. Disa prej tyre duken të brengosur sepse kanë konkuruar në këtë univerzitet. Kur dikush i pyet se si ndihen, ata përgjigjen se do të ishin njerëzit më të lumtur në botë nëse pranohen në fakultet. Megjithatë, kur t'i pyesësh për perspektivën që do ta kenë pas diplomimit dhe për kushtet e studimeve, disonimi i tyre ndryshon menjëherë, sikur t'i kishte goditur rufeja.

Fatmiri, 24 vjeçar, student i fakultetit të ndërtimeve, thotë, "Nuk mund ta përshkruaj se sa i gëzuar kam qenë kur jam pranuar në fakultet, sepse fakulteti ia hap njeriut rrugët për të pasur një ardhmëri më të lumtur. Por këto shpresa u tretën kur fillova të ballafaqohem me të gjitha pengesat, siç janë literatura joadekuate, ligjëratat e dobëta dhe stimulimi i vogël".

Shkumbini, 21 vjeçar, student i fakultetit të bujqësisë, thotë se brenga primare e tij është mungesa e materialeve laboratorike, të cilat janë të nevojshme për kompletimin e projekteve shkencore. Ai nuk sheh shumë ardhmëri në profesionin që e ka zgjedhur. Ai thotë, "Nuk do të kemë ndonjë perspektivë këtu pa zhvillim (të bujqësisë në Kosovë)".

Gëzim Krasniqi, anëtar i iniciativës studentore 'Tjetërçqysh', ka të njejtin mendim si Fatmiri. Ai thotë se për shkak të shumë mangësive, Univerziteti i Prishtinës është shëndërruar në një fabrikë për prodhimin e të papunëve të diplomuar. Ai vazhdon më tutje dhe vë në dyshim se a ia vlen të studiohet.

Thua se nuk kanë brenga të tjera, studentët ankohen se do të shkojë edhe një kohë derisa ata t'i shohin të ashtuquajturat reforma në universitet.

Në lidhje me këtë, Fatmiri thotë se reformat janë duke u zbatuar pak pasi që kuadri akademik është bukur i vjetër dhe se ata nuk mund t'i adaptohen ndryshimeve. Në anën tjetër, Shkumbini thotë se reformat janë duke u zbatuar pjesërisht, dhe e përmend se një element i tyre është studimet tre-vjeçare.

Xhavit Rexhaj, zyrtar i lartë pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka mendim të njejtë sa i përket implementimit të reformave në Universitet. Sipas tij, "Reformat janë zbatuar, por vetëm sipërfaqësisht. Udhëheqësia e Universitetit kishte vullnet dhe gatishmëri për to, por planifikimi, pjesëmarrja dhe implementimi i tyre është bërë nga lartë poshtë, pa ndonjë pjesëmarrje serioze të mesimdhënësve. Ato gjithashtu varen edhe nga mosha e profesorëve – disa i pranojnë ato më lehtë, disa më vështirë".

Gëzimi thotë se të ashtuquajturat reforma janë një përpjekje për të eksperimentuar me diçka që nuk ishte menduar mirë. Një prej tyre është reduktimi i studimeve nga katër në tre vite. Në disa vende, nevojiten katër deri



"Reformat janë zbatuar, por vetëm sipërfaqësisht.. Ato varen edhe nga mosha e profesorëve, disa i pranojnë më lehtë, disa ma më vështirësi" Foto: Sopa/OSBE

gjashtë vite për kryerjen e fakultetit.

Sipas Gëzimit, për të pasur reforma adekuate duhet të bëhen ndryshime rrënjësore. Një prej ndryshimeve kryesore është zvogëlimi i numrit të studentëve, rritja e hapësirës për studime, zëvendësimi i kuadrit mesimdhënës, përmirësimi i literaturës dhe kualitetit të ligjëratave. Sipas mendimit të tij, reformat e tanishme nuk është dashur të lejohen të fillojnë fare.

Ai e fajëson edhe bashkësinë ndërkombëtare për këtë gjendje në arsimin Kosovar duke thënë se asgjë nuk është përmendur në listën e standardave sa i përket sistemit arsimor.

Pasi që zgjedhjet janë duke u afuar, Fatmiri nuk pret ndryshime të mëdha. "Mendoj se standardet do të plotësohen pas zgjedhjeve, statusi do të zgjidhet, investimet do të fillojnë të bëhen në Kosovë dhe ardhmëria jonë do të fillojë të jetë më e mirë".

## Një gjeneratë e humbur e pensionistëve

Hapsirë e madhe e errët e mbushur me tym cigareje. Të moshuarit luajnë shah në tavolinat e mbuluara me mbulesa të njolloitura. Ata që nuk luajnë, e kalojnë kohën duke i përshpëritur njëri-tjetrit për hallet e tyre. Të tjerët rrinë ulur jashtë dhe shpresojnë për ditë më të mira.

Mevlyde Salihi

Kështu duket shoqata e pensionistëve, ku të moshuarit kalojnë ditët e tyre.

Fytyrat e rrudhosura të tregojnë qindra tregime, më shumë të hidhura se të gëzuara, që i kanë bërë jetrat e tyre të vështira por edhe interesante.

Shkallët e pastruara mirë që çojnë në zyren e kryetarit të shoqatës krijojnë një përshtypje të rreme se gjërat do të duken më mirë një kat më lartë, por gypat që pikojnë para zyes së tij të kthejnë në realitet.

"Gjendja e pensionistëve është tejet e vështirë," thotë Rasim Domi, kryetar i shoqatës. "Pas luftës (1999) pensionerëve iu është marrë statusi. Ata që janë mbi 65 vjeçar janë të gjithë të barabartë, pa marrë parasysh a kanë punuar në të kaluarën apo jo, duke marrë nga 40 euro në muaj. Mirëpo, ekziston një numër shumë i madh i atyre që janë nën moshën 65 vjeçare, të cilët kanë të drejtë në pension, por nuk marrin asgjë. Ata presin," shtoi ai.

Sipas Domit, vetëm 30% e pensionistëve kanë dikë për tu përkujdesur për ta, të tjerët duhet të jetojnë me pensionin e tyre të vogël. "Është çudi e madhe se si ia dalin," tha ai

duke shtuar, "ne kemi informacione se njerëzit dalin natën dhe kërkojnë bukë nëpër kontenjerë. Ata janë të vjetër dhe shumica dërmuese janë të sëmurë."

Idriz Lepaja, 77 vjeçar, është një nga pensionistët fatlum. Ai i përmush kriteret për të qenë në skemën e re pensionale, duke qenë



Rasim Domi, kryetar i shoqatës së pensionistëve. Foto: Sopa/OSBE

mbi 65 vjeç dhe duke dëshmuar se është banor i Kosovës. Por ajo që është më me rëndësi, ai ka fëmijë të cilët e mbështesin financiarisht.

“Ky nuk është pension, është ndihmë sociale. Unë me 40 euro nuk mund t’i paguaj as barërat që më duhen. Pas 41 vjet përvoje pune në Gjqin Komunal të Podujevës, ndihem i dëmtuar dhe i zhgënjyer që më duhet të mbështetem në fëmijët e mi për të mbijetuar,” thotë ai.

Bashkësia ndërkombëtare, e cila u ballafaqua me shumë probleme pas themelimit të saj në Kosovë në vitin 1999, dhe institucionet e sapo-krijuara të Kosovës, duket se kishin harruar tërësisht këtë problem

Vetëm në vitin 2002, një vit pas krijimit, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë. Kjo nënkuptonte se njerzit më të vjetër se 65 vjeç do të merrnin nga 28 euro në muaj, shumë e cila do të rritej për çdo vit, varësisht nga buxheti. Dy vite më vonë, kjo shumë ka arritur vetëm 40 euro.

Sidoqoftë, skema e re i ka lënë pensionistët aktual nën moshën 65 vjeçare pa asgjë, edhe nëse kanë punuar gjatë tërë jetës së tyre. Sistemi i kaluar i ka garantuar pensionet me kontributet e dhëna nga gjenerata punuese në fondin pensional. Në anën tjetër, sistemi i ri i themeluar pas konfliktit funksionon në atë mënyrë që të punësuarit paguajnë kontributet e tyre. Duket se pensionerët e tanishëm, të cilët janë pa asnjë dysh në xhep, kanë mbetur të ngujuar në mes.

“Ne jemi të vetëdijshëm se kjo nuk është zgjidhja më e mirë,” thotë Nuhi Ismajli, këshilltar i Ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale. “Ne nuk kemi bërë zgjidhje për pensionerët aktual. Skema dhe ligjet e mëparshme nuk janë më të aplikueshme. Por jam i sigurt se skema e re, ajo e pensioneve themelore dhe e trustit pensional, do të jetë e sukseshme në një afat më të gjatë kohor.”

“Zgjidhja është te një qeveri e ardhshme e fortë e me kompeteca e cila nuk mund të arsyetohet se ka kompetenca të kufizuara, dhe me një opozitë të mirëfilltë,” përfundon Ismajli.

Kryetari i shoqatës së pensionistëve të vjetërsisë poashtu shpreson se gjërat do të ndryshojnë me krijimin e qeverisë së re. “Më keq nuk mund të bëhet,” tha ai, duke shtuar, “Qeveria e parë ka bërë aq sa ka mundur, por është qeveri e re. Qeveria e ardhshme që ne do ta zgjedhim do të mund të nxjerr mësim nga Qeveria e kaluar, do të bëjë atë që e para nuk e ka bërë dhe do ta bëjë më mirë.”

Por me situatën e tanishme ekonomike në Kosovë, papunësinë dhe sistemin e ri pensional, dhe pa një plan konkret për zgjidhje në një të ardhme të afërt, gjendja e pensionerëve aktual me gjasë do të përkeqësohet edhe më tutje.

Përkundër përkrahjes deklarative nga institucionet e Kosovës, mbetet shumë për tu bërë, dhe duhet të bëhet shpejtë për këtë gjeneratë të humbur të pensionistëve, të cilët kanë bartur barrën më të rëndë.

# Mediat i nënshtrohen testit të katërt

Arben Hajredinaj, OSBE

Institucionet e Kosovës asnjëherë më parë s’kanë pasur rol më të rëndësishëm në organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta. Në mesin e faktorëve më të rëndësishëm për sukseset e tyre do të jenë se si mediat raportojnë për sjelljen e të gjitha partive të përfshira në fushatë. Në anën tjetër, mediat lokale do të jenë gjithashtu nën mbikëqyrje.

## Rregullat e rregulloret

Udhëzimet për media, të themeluara nga ‘Komisioni Qëndror Zgjedhor’ (KQZ) me ndihmën e ‘Komisionerit të Përkohshëm për Media’ (KPM), të mbështetura në rregulloret e UNMIK-ut, u bënë temë debatesh gjatë takimeve ndërmjet mediave dhe KPM-së në shtator. Përderisa mediat i pranonin rregulloret, kishte edhe të tilla që kishin rezervë lidhur me implementimin e tyre të plotë.

“Periudha e zgjedhjeve është gjithmonë e ndieshme dhe duhet caktuar rregulla për mbulimin e fushatës,” thotë Agron Bajrami, kryeredaktor i së përditëshmes ‘Koha Ditore’. Ai shprehë dyshim kur thotë se miratimi i rregullave është një gjë, ndërsa implementimi adekuat i tyre është një gjë tjetër. Ai gjithashtu theksoi se vetëm disa prej mediave do t’i mbulojnë zgjedhjet e tetorit në mënyrë profesionale.

Zijadin Gashi, gazetar i së përditëshmes ‘Zëri’, tha se përkundër rregullave të cilat kërkojnë që mediat të sigurojnë përfaqësim të drejtë dhe të barabartë në programe informative për të gjitha entitetet e certifikuar, kjo “është më shumë ‘dëshirë’ se sa realitet.” Ai theksoi vështirësitë për sigurimin e përfaqësimit të barabartë në mediat transmetuese, pasi që entitetet ndryshojnë për nga madhësia, aktivitetet apo struktura e tyre organizative në rajon.

## Profesionalizmi

Padyshim që mediat kanë një rol mjaft të rëndësishëm në formësimin e opinionit të votuesve. Gjatë mbulimit të një fushate zgjedhore është me rëndësi që ato të disponojnë me informata adekuate, dhe një pjesë e madhe e tërë kësaj varet në qasjen e tyre në ngjarje të rëndësishme. U takon mediave që të jenë profesionale dhe informuese të lexuesve të tyre dhe vazhdimisht të jenë vigjilente gjatë vlerësimit të zhvillimit të çfarëdo fushate zgjedhore. Pozita personale e një gazetari është mjaft e rëndësishme gjatë një fushate zgjedhore, në të cilën ai konsiderohet nga publiku si një krijues imazhesh të një politikani, si një sigures i paanshëm i informatave dhe si një profesionist, misioni i të cilit është t’i shërbejë publikut.

Z. Bajrami thekson rëndësinë e edukimit të votuesve. Ai thotë se votuesit duhet të jenë tërësisht

të informuar para se të sjellin një vendim. “Natyra e mediave të shtypura na lejon të futemi më thellë në analizimin e çdo deklarate,” duke shtuar që “ne s’mund të lejojmë që votuesit të zgjedhin vetëm në bazë të fjalimeve të përfaqësuesve partiakë, pasi që ne jemi përgjegjës për informim të drejtë të qytetarëve”.

Mediat duhet në mënyrë logjike t’i shqyrtojnë premtimet e bëra nga kandidatët e partive politike dhe të nxjerrin përfundime të arsyeshme prej tyre. “Votuesve duhet t’ju sigurohen perspektiva të qarta për të vlerësuar që premtimet e dhëna janë reale,” tha z. Bajrami.

## Mbulimi medial

Përderisa shumica e mediave do t’ua dedikojnë një pjesë të madhe të kohës së tyre zgjedhjeve, do të ketë edhe media të tilla që nuk do t’i mbulojnë ato për një sërë faktorësh; në mes tjerash aty përfshihen shpenzimet e larta, mungesa e resurseve njerëzore e madje edhe mosinteresimi.

Valentina Qukiq nga radio ‘Kontakt Plus’, e cila transmeton në gjuhët serbe dhe rome, thotë se do t’i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë aktive vetëm nëse serbët dhe romët dalin në zgjedhje, përndryshe ata vetëm do të raportojnë në mënyrë pasive lidhur me zgjedhjet. Qukiq gjithashtu vë në pah çështjen e sigurisë duke theksuar se minoritetet së pari duhet të kenë lirinë e lëvizjes nëse duan të raportojnë nga e tërë Kosova.

Mediat e shtypura shqipe në rajon premtojnë të raportojnë në mënyrë të balancuar nga fushatat e partive dhe të analizojnë premtimet dhe programet e entiteteve. “Politika jonë redaktuese është e qartë: raportim korrekt, objektiv dhe të paanshëm nga gazetarët tanë,” thotë Zijadin Gashi nga ‘Zëri’. Numri i pafund i aktiviteteve zgjedhore, shumica tubime, pothuajse ua bëjnë të pamundur mediave që t’i mbulojnë të gjitha ato, sqaron z.Bajrami nga ‘Koha Ditore’.

Mediat padyshim se do të përballen me shumë sfida gjatë mbulimit të zgjedhjeve të ardhshme, por në testin e tyre të katërt gjatë pesë viteve të fundit të mbulimit të zgjedhjeve, ky proces mund të duket si rutinë.



# Pyetje të shpeshta në lidhje me zgjedhjet

## Kur do të mbahen zgjedhjet?

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës do të mbahen me 23 tetor të vitit 2004. Të gjitha vendvotimet do të jenë të hapura nga ora 07:00 deri në ora 19:00. Secili votues që është në rradhë në ora 19:00 do të lejohet të ushtrojë të drejtën e tij/saj për të votuar.

## A kam të drejtë vote?

Ju keni të drejtë të votoni nëse ditëlindja juaj është para 23 tetorit të vitit 1986, DHE nëse jeni regjistruar në Qendrën Komunale për Regjistrim Civil në komunën ku ju banoni para 6 gushtit të vitit 2004 për të siguruar përfshirjen tuaj në listën e votuesve të vitit 2004.

## Ku do të votoj në Ditën e Zgjedhjeve?

Votuesit janë caktuar në një qendër votimi bazuar në adresën e tyre të banimit siç është shënuar në regjistrin civil. Në këtë lokacion do të jetë edhe emri juaj në listën e votuesve në ditën e zgjedhjeve.

## Çfarë dokumenti duhet të kam me veti për të votuar?

Ju duhet të merrni me veti të paktën një nga këto dokumenta identifikimi:

- Letërnjoftimin valid të UNMIK-ut;
- Dokumentin e udhëtimit valid të UNMIK-ut;
- Patent shoferin valid të UNMIK-ut;
- Kartelën valide të personave të zhoendosur brenda vendit;
- Kartelën valide të refugjatit.

## Nuk kam marrë përgjigje në pyetjet e mia, ku mund të marr më shumë informata?

Ju lutemi vizitoni zyret komunale zgjedhore në rajonin tuaj për të adresuar pyetje tjera që mund të keni në lidhje me zgjedhjet. Zyrtarët e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) janë në dispozicionin për t'iu përgjegjur pyetjeve në lidhje me zgjedhjet deri një ditë para zgjedhjeve. Një tavolinë për të ndihmuar votuesit do të vendoset në secilin vendvotim në ditën e zgjedhjeve. Më poshtë do të gjeni informatat për të kontaktuar KKZ-të



SECRETARIAT

Central Election Commission  
Komisioni Qendror i zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija

Prishtinë, Arbëri, Tel: +381 38 240 722 , Fax: +381 38 240 719

Kodi	Komuna	Emri	Telefoni	Adresa
1	Deçan	Xhavit Rexhahmetaj	044 / 393 – 722	Shtëpia e Kulturës
2	Gjakovë	Xhevdet Bytyqi	044 / 393 – 727	Shtëpia e Kulturës
3	Glogoc	Bilall Shehu	044 / 393 – 712	Baraka afer Kuv. Kom
4	Gjilan	Ferid Shabani	044 / 393 – 715	Kuvendi Komunal
5	Dragash	Sehadin Misini	044 / 393 - 726	Ndert. e vjet e K.K
6	Istog	Bashkim Ademaj	044 / 393 – 723	Shtëpia e Kulturës
7	Kaçanik	Qemajl Hamdiu	044 / 393 – 719	Ndërtesa e SHPK
8	Klinë	Idriz Dushi	044 / 393 - 724	Kuvendi Komunal
9	Fushë Kosovë	Skender Dumani	044 / 393 - 709	Kuvendi Komunal
10	Kamenicë	Agim Kastriati	044 / 393 – 722	Shtëpia e Kulturës
11	Mitrovicë	Gani Mikullovi	044 / 393 – 730	Kuvendi Komunal
12	Leposaviq	Milosav Markovic	063 / 857 – 6839	Shtëpia e Kulturës
13	Lipjan	Hamza Kadriu	044 / 393 – 724	Kuvendi Komunal
14	Novobërdë/	Selim Mehmeti	044 393 – 716	Kuvendi Komunal
15	Obiliq	Haki Krasniqi	044 / 393 – 710	Kuvendi Komunal
16	Rahovec	Illir Popaj	044 / 393 - 728	Ndert.e Zjarrfiksëve
17	Pejë	Mehrije Hoti	044 / 393 – 721	Ndert.e KK. Pran Shtëp. Kul.
18	Podujevë	Islam Demolli	044 / 393 – 711	Kuvendi Komunal
19	Prishtinë	Fatmire Bajrami	044 / 393 – 708	Kuvendi Komunal
20	Prizren	Nysret Bytyqi	044 / 393 – 735	Ndertesë e DPU
21	Skenderaj	Imer Ahmetaj	044 / 393 - 732	Shtëpia e Kulturës
22	Shtime	Florije Mulaj	044 / 393 - 714	Ish Shtëpia e Mallrave
23	Shtërpçë	Milan Janicijevic	063 / 844 – 9943	Private House beside Assembly
24	Suharekë	Refki Gega	044 / 393 – 725	Kuvendi Komunal
25	Ferizaj	Idriz Hetemi	044 / 393 – 718	Kuvendi Komunal
26	Viti	Skender Hoda	044 / 393 – 717	Kuvendi Komunal
27	Vushtrri	Elez Krasniqi	044 / 393 - 731	Kuvendi Komunal
28	Zubin Potok	Goran Bacvarovic	063 / 855 – 0981	OJQ "CCD" pran Shkollës fillore
29	Zveçan	Viktorija Milisavljevic	063 / 895 – 0673	Shtëpia priv.pran K.K
30	Malishevë	Rexhep Zogaj	044 / 393 – 729	Kuvendi Komunal

Për pyetje tjera të përgjithshme ju lutemi vizitoni:

[www.cec-ko.org](http://www.cec-ko.org) • [www.kosovoelections.org](http://www.kosovoelections.org)

[www.zgjedhjetekosoves.org](http://www.zgjedhjetekosoves.org) • [www.kosovskiizbori.org](http://www.kosovskiizbori.org) • [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)